



Biografi e shkurtër

Donalda Baku është diplomuar në vitin 2007 në degën Financë - Kontabilitet në fakultetin e Ekonomisë, pranë Universitetit Shtetëror të Tiranës. Në vitin 2015 ka përfunduar ciklin Bachelor për Drejtësi dhe në vitin 2017 ka përfunduar studimet Master Shkencor në degën “E Drejtë Civile Tregtare” në Fakultetin e Drejtësisë, pranë një universiteti privat në Tiranë. Ka një përvojë pune 11-vjeçare në sistemin bankar, në banka të nivelit të dytë.

Gjatë viteve 2008 - 2010 ka punuar në “Emporiki Bank Albania S.A” në departamentin e Financës, si specialiste në sektorin e Kontabilitetit dhe Taksave dhe më pas, në sektorin e Buxhetimit/MIS.

Gjatë viteve 2010-2012 ka punuar në “Emporiki Bank Albania S.A”, në departamentin e Financës, si drejtore e Sektorit të Raportimeve.

Gjatë viteve 2012-2015 ka punuar në “Credit-Agricole Bank Albania S.A” në departamentin e Financës, si drejtore e Sektorit të Raportimeve.

Gjatë viteve 2015-2019 ka punuar në “American Bank of Investments Albania S.A” (ABI Bank) në departamentin e Financës, si drejtore e Sektorit të Raportimeve.

Zotëron gjuhën angleze dhe italiane.

Nga janari 2019 , është pjesë e strukturës së Njesisë së Shërbimit Ligjor pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelitit, me detyrën këshilltare ekonomike.